



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Tiranë, më 25.06.2021

N J O F T I M

Mbështetur në Vendimin e Rektorit nr.116, datë 25.06.2021 “Për rishpalljen e konkursit për pranimin e dy punonjësve si personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2020 – 2021, në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit”, njoftohen të gjithë kandidatët e interesuar që duan të aplikojnë për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagogë të jashtëm), se duke filluar nga data **25.06.2021 deri më 01.07.2021**, duhet të dërgojnë më anë të shërbimit postar në Protokollin e Universitetit të Sporteve të Tiranës, dokumentacionin përkatës sipas specialitetit ku aplikojnë.

I. DEPARTAMENTI I VEPRIMTARISË FIZIKE, REKREATIVE DHE TURIZMIT

- **Turizëm** (Mod.Kamping veror)- **Bachelor** 2 (dy) Lektor ose As/Lektor

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për lëndët e aplikuar në Departamentin e Veprimtarisë Fizike, Rekreative dhe Turizmit janë si më poshtë:

1. Të ketë mbaruar studimet e larta në nivelin Master Shkencor (ose ekuivalent me të) në Specialitetin e lëndës përkatëse ku konkurron. **15 pikë**
2. Të ketë notë mesatare të studimeve të larta mbi 8 (tetë). **15 pikë**
3. Të ketë përvojë pune Akademike mësimdhënëse e kërkimore në fushën përkatëse në Institucionet e Arsimit të Lartë, preferohet FVFR. **26 pikë**
4. Të zotërojë njërën nga gjuhët e BE: anglisht, frëngjisht, spanjisht, gjermanisht, italisht me dëshmi. **10 pikë**.
5. Të ketë njohuri të përdorimit të programeve kompjuterike bazë . **10 pikë**
6. Kanë preferencë kandidatët që kanë Grada dhe Tituj shkencor. **15 pikë**
7. Të ketë kryer aktivitet shkencor si: referime, botime brenda dhe jashtë vendit. **3 pikë**
8. Të ketë eksperiencë praktike dhe specializim në fushën e mësipërme. **3 pikë**
9. Vlerësohen kualifikimet dhe trajnimet e ndryshme brenda dhe jashtë vendit në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës. **3 pikë**

Kriteret nga 1) deri në 2) janë kriteret bazë dhe kandidati nëse nuk i ka, skualifikohet; kriteret nga 3) deri në 9) janë kriteret preferenciale.

- II. Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë vetëm nëpërmjet postës, duke shënuar qartë mbi zarf, pozicionin për të cilin konkurojnë, departamentin, fakultetin, lëndën ku aplikojnë, dokumentacionin e mëposhtëm:

- ✓ Curriculum Vitae (e detyrueshme)
- ✓ Diplomë dhe Certifikatë e notave të studimeve Bachelor (fotokopje e noterizuar) (e detyrueshme)
- ✓ Diplomë dhe Certifikatë e notave të studimeve Master i Shkencave ose DIND (fotokopje e noterizuar) (e detyrueshme)
- ✓ Certifikatën e gradës “Doktor i Shkencave” (nëse ka) (fotokopje)
- ✓ Dëshminë e titullit “Profesor i Asociuar” (nëse ka) (fotokopje)
- ✓ Dëshminë e titullit “Profesor” (nëse ka) (fotokopje)
- ✓ Fotokopje e kartës së identitetit (fotokopje) (e detyrueshme)
- ✓ Dëshmi penaliteti (vetëdeklarim) (e detyrueshme)
- ✓ Numrin e llogarisë bankare (nëse ka) (fotokopje)
- ✓ Vërtetim nga qendra e punës me lejen për t’u angazhuar si staf akademik me kohë të pjesshme pranë FVFR – UST (nëse është i punësuar)
- ✓ Vërtetim nga Dega e Tatim Taksave në rast se është i/e papunësuar.
- ✓ Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

III. Vetëm paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.

IV. Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti, Departamenti, **specialiteti ku aplikon**, emri, mbiemri, Nr. telefonit dhe e-mail i konkurentit.

V. Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

R E K T O R

Prof. Dr. Agron KASA